



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tiranë

Tel: 355 4 2268 142; Fax: 355 4 2268 141

Nr. 297 Prot.

Tiranë, më 23.03.2016

V E N D I M

Nr. 28, datë 23.03.2016

**“Për kryerjen e verifikimit në lidhje me zbatimin e Vendimit nr. 43, datë 27.04.2015,
“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil,
Instituti i Mjekësisë Ligjore”**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil.

Për këtë arsye,

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Vendimit nr. 43, datë 27.04.2015, në institucionin Instituti i Mjekësisë Ligjore,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 43, datë 27.04.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Instituti i Mjekësisë Ligjore” në këtë institucion, sipas objektit dhe anekseve që përmban Programi i Verifikimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Ngritjen e grupit të verifikimit, me këtë përbërje:
 - Dorina Nika, specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë;
 - Ilirjan Osmanlliu, specialist në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Procesi i verifikimit të zbatimit të këtij vendimi do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt në datën 31.03.2016 dhe do të vijojë deri në datën 01.04.2016.
4. Me përfundimin e verifikimit në subjekt, grupi i punës do të vijojë me përgatitjen e relacionit, i cili, pas konsultimit me Drejtorin e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, do t'i paraqitet për miratim Komisionerit dhe më tej do të hartohet vendimi për përmbylljen e këtij procesi.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur; Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Ministrisë së Drejtësisë dhe Departamentit të Administratës Publike.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë që të marrë masat për realizimin e procesit të verifikimit duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet verifikimit në përputhje me nenin 47 të Kodit të Procedurës Administrative dhe akteve që janë pjesë e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tiranë

Tel: 355 4 2268 142; Fax: 355 4 2268 141

Nr. 297/1 Prot.

Tiranë, 23.03.2016

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit)

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Instituti i Mjekësisë Ligjore**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit nr. 43, datë 27.04.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Instituti i Mjekësisë Ligjore”*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14 i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe neni 34 e vijues i rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Periudha e verifikimit:** Verifikimi do të përfshijë zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Vendimin nr. 43, datë 27.04.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Instituti i Mjekësisë Ligjore”*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nga ana e Njesisë Përgjegjëse të institucionit të mbikëqyrur.

- 5. Afati i verifikimit:** Verifikimi do të fillojë në institucion në datën 31.03.2016 dhe do të përfundojë brenda datës 01.04.2016.
- 6. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahet proces-verbal administrativ, i cili nënshkruhet, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.
- 7. Grupi i punës:**
- 1. Dorina Nika** Specialist, jurist
 - 2. Ilirjan Osmanlliu** Specialist, jurist
- 8. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:** Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në procesverbalin e mbajtur në subjektin e verifikuar dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do t'i dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar*).

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

1. Si janë zbatuar nga ana e Njesisë Përgjegjëse të institucionit të mbikëqyruar në raport me ligjin, rekomandimet e dhëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin nr. 43, datë 27.04.2015, "*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Instituti i Mjekësisë Ligjore*", të renditura më poshtë:
 - Vendimi & konkluzionet e raportit përfundimtar;
 - Pasqyrimi në Rregulloren e Brendshme të institucionit, të parimeve dhe rregullave që sanksionohen nga legjislacioni për shërbimin civil, për shkak të përfshirjes së tij në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil;
 - Saktësimi i rastit të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësen ***** nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit dhe nga Departamenti i Administratës Publike, deklaruar mbi numrin e pozicioneve të punës të përcaktuara në strukturë në sektorin e shërbimeve mbështetëse;
 - Ndryshimi i aktit të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin ***** në pozicionin "*Ekspert Mjekoligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë*", duke i shtuar faktin që punonjësi duhet të konsiderohet në periudhë prove dhe zbatimi i gjithë kërkesave që parashikon ligji për konfirmimin e tij si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës;

- Përfundimi i procesit të verifikimit të gjendjes gjyqësore për nëpunësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe materializimi i këtij procesi në dosjen e personelit;
 - Verifikimi i plotësimit të dosjes së personelit në rastet e konstatuara me mungesa në aneksraportet, pjesë e vendimit të sipërpërmendur.
2. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Vendimin nr. 43, datë 27.04.2015, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, Instituti i Mjekësisë Ligjore”*.

9. Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Rregullore e brendshme e institucionit.
2. Provat shkresore, të cilat vërtetojnë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me punonjësen ***** dhe *****.
3. Dosjet e personelit.

**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI

DREJTOR